

Ndërkohë që Shqipëria po zbrazet, po shpopullohet, ndërkohë që zona të tëra po shkretohen duke u larguar të rinj e të vjetër, duke lënë pothuajse në shkreti qarqet, qytetet tradicionale dhe zonat rurale, të cilat tradicionalisht kanë mbajtur një peshë të rëndësishme për Shqipërinë, qeveria e Republikës së Shqipërisë ka zgjedhur të sjellë një ligj që, thelbësisht, lidhet vetëm me interesat e disa oligarkëve rrotull saj, të cilët janë edhe propozuesit e këtij ligji. Pa diskutim, të dhënat e Eurostat-it, të përmendura nga kolegët, e kanë të qartë shifrën prej 189 mijë e 975 qytetarë shqiptarë, që kanë kërkuar azil ekonomik, por për numrin e qytetarëve shqiptarë të larguar nga Shqipëria, ende sot e kësaj dite, nuk ka shifra të sakta.

E kemi pyetur ministrin e Brendshëm në komision, do ta pyes edhe tani: sa është numri i shqiptarëve të larguar nga Shqipëria? A jemi ne një shtet pa inventar, që nuk e dimë se sa qytetarë hyjnë dhe dalin, pra nuk kemi kontroll? Përveç kontrollit në territor, nuk kemi kontroll për hyrjet-daljet e qytetarëve shqiptarë, të cilët largohen në mënyrë ilegale ose tejkalojnë afatin 3-mujor të përcaktuar nga afati i vizave? Ne nuk e dimë ende sot. Shifra është 500 mijë, por mund të jenë 600 mijë. Kjo situatë ka krijuar një problem, që nuk besoj se ka kolegë deputetë, që në zonat e tyre të mos u thonë se ky është një problem themelor. Problemi themelor që ka sipërmarrja shqiptare sot, bizneset, sidomos turizmi, është se nuk kanë punonjës. Çfarë bën qeveria? Në vend të një politike, që do të synonte krijimin e vendeve dhe kushteve më të mira të punës për qytetarët shqiptarë, që ata të qëndrojnë këtu, qeveria ofron lehtësira për shtetasit e huaj, që të përfshihen në tregun shqiptar të punës. Pa diskutim, shtetasit që do të vijnë janë krahë pune, por ata do të plotësojnë 1 mijë procedura, do të kalojnë në një komision të ngritur nga ministri i Brendshëm, dhe, për shkak të kapaciteteve, nuk plotësojnë dot mungesat e punonjësve në një restorant apo bar në buzë të detit, as mungesat për punonjës në qytetet e Shqipërisë, por plotësojnë vetëm në disa kompani, të cilat kanë sjellë edhe ligjin. Ndërkohë që ne jemi në këtë situatë, ku kemi një shtet pa inventar, në medie qarkullojnë lajmet e emigrantëve në Pogradec, që mbushnin furgonat plot për t'u larguar. Dy policët nuk dinin ku të fusnin dorën për pistoletën; fusnin dhe nxirrnin duart nga xhepi, duke bërë të largoheshin më shumë se 30 emigrantë me atë furgon. Cilat janë arsytet që largohen shqiptarët? Këtu duhet të përqendrohemi. Qeveria e Shqipërisë po bën gjithçka që të krijojë një pabarazi mes qytetarëve shqiptarë, duke i përqendruar të gjitha pasuritë publike, të gjitha burimet natyrore vetëm në një grusht njerëzish dhe ka varfëruar, ka krijuar dhe krijon ekstremite në kushtet e punës për qytetarët shqiptarë, si edhe në pagat që ata marrin.

Ndërkohë që ne nuk kemi inventar, nuk kemi kontroll në territor, shikojmë që çdo disa orë në lagjet e Shqipërisë dëgjohen armë, ndodhin vrasje të stilit mafioz, që nuk kanë ndodhur më parë në këtë vend, vrasje pa autorë, disa me djegie makinash, ku gjenden vetëm makinat e djegura, kurse elementët kriminalë, apo ata që kryejnë vrasjet, nuk gjenden kurrë. Policia është kthyer në agjenci lajmesh. Shikojmë avionë droge, të cilët, në kulmin e mbjelljes së kanabisit në Shqipëri, nuk dihet nga kanë ardhur, ku ishin, çfarë flamuri kanë dhe cilët persona i përdornin. Ne ndodhemi në situatën ku nuk kontrollojmë dot territorin me kaq pak banorë sa kanë mbetur dhe marrim përsipër të rrëzojmë dekretin e Presidentit për kthimin e një ligji, që synon ta kthejë Shqipërinë në magazinë të depozitimit të emigrantëve dhe, pa diskutim, në një qendër të trafikut ilegal të emigrantëve, siç është edhe sot. Çdo ditë ka lajme, dhe shumë e më shumë po ndodhin. Sipas raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit, vendi ynë është kthyer në qendër operacionale për trafikun e drogave të rënda, sepse një herë në javë, për shkak të skanerit dhe të partnerëve ndërkombëtarë, kapet kokainë. Sipas raportit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara ne jemi vendi i parë për prodhimin e kanabisit në Europë.

Ndërkohë, marrim përsipër të sjellim dhe ta mbushim Shqipërinë me emigrantë, të cilët nuk do të qëndrojnë këtu (këtu do të jemi), por do ta përdorin vendin vetëm si tranzit. Sapo të marrin pasaportat dhe të përfitojnë të gjitha lehtësitë, do të largohen. Në këtë mënyrë nuk do t'u lihet mundësi shqiptarëve, të cilët duan të punojnë dhe të jetojnë këtu, që të aplikojnë për vende pune. Ata do të largohen, pasi nuk do t'u jepet asnjë mundësi për rritjen e mëtejshme të pagës së tyre. Në këtë ligj ka një dispozitë ku parashikohet se vendet e punës do t'u ofrohen fillimisht punëkërkuësve shqiptarë, por afatet e shkurtra për të verifikuar ekzistencën e punëkërkuësve shqiptarë të përshtatshëm për atë vend pune, e bëjnë edhe këtë dispozitë thjesht deklarative dhe sa për të larë gojën. Situata e rëndë e gjendjes ekonomike të qytetarëve shqiptarë tregon se për shkak të pamundësisë, të mungesës së të ardhurave, mungesës së mundësive të shanseve të barabarta dhe pasigurisë ligjore, vitet e fundit ata e kanë humbur besimin se cilësia dhe kushtet e jetës së tyre në Shqipëri mund të përmirësohen dhe për këtë shkak ata po largohen masivisht. Ardhja e këtyre njerëzve, që do të jenë makineri, sepse nuk kanë gojë të flasin për t'i kërkuar llogari qeverisë, do të bëjë të heshtet për dhjetëra e dhjetëra skandale korruptive, që përditë po e shkretojnë Shqipërinë. Mediet e kanë të përditshme. Sot, tek Unaza, fiton oferta më e shtrenjtë, 17,4 milionë. Para dy ditës: OSHEE-ja, 10 milionë euro më shtrenjtë se çmimi i tregut. Opozita, media dhe qytetarët denoncojnë përditë skandale korruptive, për cilësitë mizerabël të shërbimeve, si në shërbimet spitalore, në shërbimet e arsimit, apo në kushtet e papërbalueshme dhe të këqija të vendeve të punës. Për këtë arsye, duke qenë se ky ligj është bërë për t'i shërbyer vetëm një klani të ngushtë personash rrotull qeverisë, ne do të votojmë pro dekretit të Presidentit dhe kundër këtij ligji klientelist. Faleminderit!